

Zbatimi i MSA-së në nivel komunal

Të arriturat dhe sfidat në
shtatë komunat më të mëdha



Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është produkt i Institutit GAP dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së.

Përmbledhje ekzekutive

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA), e ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës në nëntor 2015, parasheh që vendi ynë të ndërmarrë një varg masash dhe reformash me qëllim të integritimit në Bashkimin Evropian (BE). Një numër i këtyre masave bie nën përgjegjësinë e komunave të Kosovës.

Gjetjet e Institutit GAP tregojnë se komunat kanë probleme të theksuara në zbatimin e pjesës së obligimeve të tyre në përmbushjen e kësaj marrëveshjeje. Në përgjithësi del se rregullorja 08/2011 e Zyrës së Kryeministrit, lidhur me rolin që duhet të luajnë zyrat për integritime evropiane nëpër komuna nuk është zbatuar sa duhet. Kjo rregullore specifikon se të gjitha komunat duhet të kenë një strukturë unike për integritime evropiane, gjë kjo e cila nuk haset në terren. Disa komuna kanë vetëm zyrat/e për integritime, ndërsa disa të tjera kanë zyre apo drejtori për integritime evropiane. Përveç kësaj, rregullorja 08/2011 kërkon nga komunat që zyrat për integritime evropiane duhet 1) të përfaqësohen në të gjitha takimet e rregullta të Këshillit të Drejtorëve në komunë, 2) të marrin pjesë në hartimin e akteve juridike dhe atyre strategjike komunale, 3) të jenë të përfaqësuar në planifikimet buxhetore si dhe 4) të konsultohen në lidhje me planet e punës së komunës. Gjetjet e Institutit GAP tregojnë se asnjëra nga këto nuk respektohet nga ana e komunave.

E arritur më e madhe për nivelin lokal në lidhje me agjendën evropiane është saktësimi i obligimeve që kanë komunat në përmbushjen e MSA-së. Procesi i përmbushjes së MSA-së të rasti i komunave koordinohet dhe menaxhohet nga ana e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). Kjo ministri nuk bën vlerësim nga terreni për të parë nëse raportimet e zyrarëve komunal janë të plota dhe të sakta, por bazohet në raportimet me shkrim që bëjnë zyrat për integritime evropiane në MAPL.

Asnjëra nga zyrat për integritime evropiane nuk ka ndjekur ndonjë trajnim se si të aplikohet në fondet e BE-së dedikuar Kosovës. Pamundësia për të aplikuar në këto fonde po rezulton me humbjen e mundësisë që komunat t'i realizojnë disa nga planet e tyre. Zyrat për integritime evropiane nuk kanë qasje në data bazën e komunës për të parë se çfarë trajnimesh po merr pjesë stafi dhe po ashtu këto zyre nuk posedojnë të dhënat në lidhje me numrin dhe natyrën e organizatave jo-qeveritare që funksionojnë në komunat përkatëse.

Zyrat për integritime evropiane nëpër komuna janë përballur edhe me problemin e largimit të stafit nga puna dhe kështu në pjesën më të madhe të rasteve është dëmtuar kujtesa institucionale në lidhje me aktivitetet e përmbushura dhe planet e synuara.

Zyrtarët komunal për integritime evropiane nuk kanë asnjë takim gjatë vitit me udhëheqësit e Ministrisë së Integritimit Evropian (MIE). Kontributi i nivelit lokal nuk potencohet dhe nuk vlerësohet nga ana e kësaj ministrie, gjë kjo e cila ndikon negativisht në inkurajimin e këtyre zyrtarëve për punën që bëjnë.

Të arriturat me të mëdha nga niveli lokal në përmbushjen e MSA kanë dalë të jenë themelimi dhe inkuadrimi i minoriteteve në këshillat për siguri në bashkësi, zbatimin e obligimeve ligjore në përdorimin e gjuhëve zyrtare, ndërmarrja e masave në mbrojtjen e të dhënave personale, evidentimi i shkallës së braktisjes së shkollës nga nxënësit, largimi i deponive të egra nga zonat e banuara si dhe e arritur tjetër vlerësohet hartimi i planeve komunale në efikasitet të energjisë.

Ndërsa sfidat më të mëdha që kanë komunat në përmbushjen e MSA-së janë reforma e administratës publike në nivel lokal, mbrojtja e trashëgimisë kulturore, mbrojtja e tokës bujqësore dhe resurseve pyjore, zbatimin e rekomandimeve të auditorit si dhe mbrojtja e shëndetit publik.

Ky raport pasqyron të arriturat dhe sfidat që kanë komunat në zbatimin e MSA-së, si dhe ofron një varg rekomandimesh mbi fuqizimin e zyrave komunale për integritime evropiane dhe adresimin e sfidave që ka pushteti lokal në përmbushjen e kushteve që dalin nga agjenda evropiane.

Hyrje

Me ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) nga Kuvendi i Kosovës, Kosova ka marrë përsipër përmbushjen e të gjitha kushteve që dalin nga ky dokument. MSA përmban tri shtylla, atë politike, ekonomike dhe atë të standardeve evropiane. Këto tri shtylla janë të ndara në dhjetë kapituj të cilat prekin tërë sistemin e qeverisjes, duke përfshirë edhe qeverisjen lokale. Ajo që kërkohet nga Kosova është plotësimi i kushteve teknike dhe atyre juridike në sferën e drejtësisë, sigurisë, energjisë, administratës, e shërbimeve publike. Përveç këtyre, kërkohet po ashtu koordinim ndërinstitucional e bashkëpunim ndërkufitar, krijim të një tregu të lirë dhe konkurrent e deri te të drejtat e njeriut, ato të komuniteteve, reforma në fushën e arsimit, fuqizim dhe mbrojtje në fushën e kulturës si dhe adresim të çështjeve sociale dhe problematikave urbane.

Në nivel kombëtar, procesi i përmbushjes së kushteve që dalin nga MSA menaxhohet nga Ministria e Integrimit Evropian (MIE), ndërsa përmbushja e kushteve që bien në kompetenca të komunave menaxhohet nga ana e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). MIE e horton dhe e dërgon për miratim në Kuvend të Kosovës, Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së. Ky plan është katër vjeçar (2018-2022) dhe nga aty dalin planifikimet strategjike për hapat që duhet të ndërmerren në rrafshin institucional për t'i përmbushur kushtet e MSA-së.

Por, vetë procesi i përmbushjes së MSA-së nuk është i afatizuar. Nga përvoja e vendeve tjera si rasti i Shqipërisë, nga nënshkrimi i MSA në 2006, janë dashur të kalojnë 12 vite deri te mundësia e hapjes së negociatave (hapja e 34 kapitujve) për anëtarësim në BE.¹ Procesi i vlerësimit të përmbushjes së kushteve të dala nga MSA bëhet bashkërisht ndërmjet vendit nënshkrues dhe mekanizmave të BE-së.

Institucionet e Kosovës dhe ato të BE-së, me qëllim të konkretizimit dhe fokusimit në prioritetet e caktuara që dalin nga MSA, kanë nxjerr një dokument që njihet si Agjenda për Reformën Evropiane (ERA). Për këtë qëllim janë përcaktuar prioritetet njëvjeçare në fushat e qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit, konkurrueshmërisë dhe klimës së investimeve si dhe në fushën e arsimit e punësimit.

Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA i vitit 2016 tregon se një mori e kushteve të parapara për t'u plotësuar bien në përgjegjësi të qeverisjes lokale. MAPL ka marrë përsipër t'i saktësojë këto obligime si dhe të koordinojë dhe menaxhojë gjithë procesin për nivelin lokal. Instituti GAP ka zhvilluar këtë hulumtim në shtatë komuna të Kosovës (Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Gjiilan, Gjakovë, Ferizaj) me qëllim të vlerësimit të përgjegjësisë që kanë komunat në përmbushjen e MSA-së dhe për të parë se cilat janë të arriturat dhe sfidat në këtë proces.

Metodologjia

Për hartimin e këtij raporti janë zhvilluar intervista me të gjithë zyrtarët e integritimeve evropiane në shtatë komunat e mëdha (Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë dhe Ferizaj). Janë konsultuar dhe intervistuar zyrtarët e lartë të MAPL-së, Asociacionit të Komunave të Kosovës si dhe ekspertë të fushës së integritimeve evropiane. Po ashtu, janë mbajtur shtatë fokus grupe në shtatë komuna të Kosovës ku janë përfaqësuar zyrtarë komunal, zyrtarë të Ministrive së Administrimit të Pushtetit Lokal, shoqëria civile, mediat dhe njohës të politikave lokale dhe atyre të integritimeve evropiane. Në hartimin e këtij raporti jemi shërbyer me dhjetëra dokumente zyrtare të pranura nga komunat, MAPL dhe MIE.



¹ Lëvizja Evropiane në Shqipëri. Procesi i anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Historiku i marrëdhënieve. Burim: <https://bit.ly/2MrmvKh>

Roli i komunave në procesin e integritimit evropian

Përgjegjësia e komunave në procesin e integritimit evropian bazohet në dokumente të nivelit nacional. Fillimisht, komunat në vitin 2013, janë angazhuar në procesin e riatdhesimit të personave që ju është refuzuar azili në shtetet e BE-së. Kjo ka qenë një përgjegjësi e bartur nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe ajo e Punës dhe Mirëqenies Sociale.² Në vitin 2015, komunat kanë marrë rol në plotësimin e disa kushteve që kishin të bënin me liberalizimin e vizave të qytetarëve të Kosovës që dëshirojnë të udhëtojnë në shtetet e BE-së.³ Paralelisht me këto, komunat kanë marrë instruksione nga MAPL dhe MIE në lidhje me obligimet që kanë ato në përputhje me të gjeturat vjetore që publikon Komisioni Evropian përmes raportit të vendit. Ndërsa në vitin 2016, komunat kanë nisur ta adresojnë përmbushjen e kriterëve që dalin nga MSA.⁴

Të gjitha komunat e Kosovës kanë funksionale zyrat për integritime evropiane. Këto zyra u krijuan në vitin 2008 si rezultat i shuarjes së zyrave të deriatdeshme që lidheshin me përmbushjen e standardeve para statusit.⁵

Deri në vitin 2011, roli i këtyre zyrave ka qenë i paqartë. Në këtë kohë, Zyra e Kryeministrit e nxjerr rregulloren nr.08/2011 që i dedikohet ekskluzivisht rregullimit dhe detyrave që duhet të kenë Zyrat Komunale për Integritime Evropiane.⁶

Kjo rregullore specifikon se zyrat për integritime evropiane shtrihen në të gjitha komunat dhe janë përgjegjëse për koordinimin e procesit të zhvillimit të kornizës rregullative dhe të politikave të komunës që ndërlidhen me procesin e integritimit evropian dhe që dalin nga dokumente strategjike, si ato nacionale ashtu edhe ato lokale. Në koordinim me kryetarët e komunave si dhe me të gjitha strukturat e tjera vendimmarrëse komunale, këto zyra marrin pjesë në hartimin e planit vjetor të komunës, me qëllim të reflektimit të prioritetëve dhe objektivave që përmbajnë dokumentet strategjike komunale.

Përveç kësaj, kjo rregullore u jep zyrave për integritime evropiane detyra për të mbikëqyrur aktet juridike të komunës nëse të njëjtat janë në përputhje me direktivat e BE-së. Po ashtu, këto zyra kanë përgjegjësi

që në bashkëpunim me Zyrën e Personelit në komunë të kujdesen për ngritjen e kapaciteteve të stafit në çështjet që lidhen me integritimin evropian.

Në rregullore nuk specifikohet numri i stafit që duhet të ketë kjo zyrë dhe po ashtu nuk është i rregulluar koeficienti i pagës që bartin zyrtarët dhe udhëheqësit e zyrës për integritime evropiane.

Edhe pse kjo rregullore ka hyrë në fuqi në vitin 2011, komunat kanë marrë rol aktiv në agjendën evropiane vetëm në fillim të vitit 2014. Kjo, ngase në vitin 2013, MAPL themeloi brenda vetes Drejtorinë për Integritime Evropiane me qëllim të koordinimit dhe menaxhimit të agjendës evropiane në nivel komunal.⁷

Në mesin e kriterëve që Kosova ka pasur për t'i përmbushur për liberalizim të vizave disa prej tyre kanë qenë përgjegjësi dhe kompetencë e pushtetit lokal. Përgjegjësitë fillestare të komunave në këtë proces janë lidhur me azhurnimin e të dhënave të gjendjes civile si dhe bërjen transparente të sporteleve komunale gjatë kontakteve që kanë qytetarët me zyrtarët. Pastaj detyra shtesë kanë dalë të jenë krijimi i hapësirave për qasje të papenguar të personave me aftësi të veçanta në objektet publike, hapja e zyrave të avokatit të popullit në objektet e komunës, përdorimi i gjuhëve zyrtare në dokumente publike, themelimi i këshillave lokal për siguri në bashkësi dhe inkuadrimi i minoriteteve në këto këshilla, fuqizimi i rolit të komunave në procesin e riatdhesimit dhe ri-integritimit si dhe krijimi i lehtësirave në regjistrimin e bizneseve. Përveç këtyre obligimeve që janë lidhur direkt me komuna, këto të fundit kanë pasur edhe përgjegjësi të kufizuar në lidhje me adresimin e çështjeve të dhunës në familje, barazisë gjinore, mbrojtjen e fëmijëve nga punët e renda dhe çështjeve që janë lidhur me luftën kundër korrupsionit dhe nepotizmit.⁸

2 Qeveria e Kosovës. Zyra e Kryeministrit. Strategjia kombëtare për ri integritimin e personave të riatdhesuar. Fq 19 & 20. Burim: <https://bit.ly/2Oe62uR>

3 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Udhëzues për rolin e komunave në procesin e integritimit evropian. Fq 35. Burim: <https://bit.ly/2QrZfPS>

4 Intervistë me drejtorin e drejtorisë për integritime evropiane në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal Shkelqim Jakupi.

5 Ibid

6 Qeveria e Kosovës. Zyra e Kryeministrit. Rregullore për organizimin dhe përgjegjësitë e zyrave për integritime evropiane. Rregullore 08/2011. Hyrja në fuqi 30.06.2011. Burim: <https://bit.ly/2PukbQS>

7 Intervistë me drejtorin e Drejtorisë për Integritime Evropiane në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal Shkelqim Jakupi

8 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Udhëzues për liberalizimin e vizave. Prishtinë, nëntor 2013. Burim: <https://bit.ly/2LXN89D>

Detyrat e komunave në përmbushjen e MSA-së

MSA nuk saktëson se cilat institucione janë përgjegjëse për arritjen e kushteve të parapara në këtë dokument.⁹ Ky është një proces të cilin e menaxhon MIE. Kjo e fundit ka hartuar Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA). Fillimisht ky dokument ka qenë një vjeçar (2016) pastaj ka kaluar në planin katër vjeçar 2017-2021, por për shkak të disa ndryshimeve dhe plotësimeve që është dashur të behën është rikthyer në Kuvend të Kosovës për miratim dhe tani PKZMSA-se është për periudhën 2018-2022.¹⁰

Nga ky plan dalin përgjegjësitë dhe detyrat për të dy nivelet e pushtetit, atë qendror dhe lokal. Pastaj, në bazë të kësaj, miratohen planet e veprimit, planet e punës dhe matrica e aktiviteteve. Përgjegjësinë për përgatitjen e matricave dhe planit të veprimit për obligimet e komunave kundruall MSA-së e ka MAPL. Kjo ministri luan një rol aktiv jo vetëm në përgatitjen e këtyre dokumenteve, por edhe në koordinimin dhe monitorimin e tërë procesit të përmbushjes së MSA-së nga niveli lokal.

Në bazë të matricës së aktiviteteve që duhet t'i ndër marrin komunat për përmbushjen e kushteve të MSA-së, e përgatitur nga MAPL, komunat kanë 146 detyra konkrete për t'i ndërmarrë. Këto detyra ndahen në tri fusha, atë politike, ekonomike dhe fusha e standardeve evropiane.¹¹

Të arriturat e komunave në përmbushjen e obligimeve që dalin nga MSA-ja

Kosova është i vetmi vend në rajon i cili zotimin për integrim në BE e ka përfshirë edhe në preambulën e Kushtetutës.¹² Ky zotim ka shtyrë institucionet që të themelojnë organe dhe mekanizma të ndryshëm që kanë funksion përmbushjen e obligimeve integruese. Kosova e ka Ministrinë për Integrim Evropian dhe secila ministri e Qeverisë së Kosovës e ka të themeluar departamentin për integrim evropiane. Komunat i kanë të themeluara zyrtat për integrim dhe Kuvendi i Kosovës e ka funksional Komisionin Parlamentar për Integrim Evropian, Asociacioni i komunave të Kosovës e ka formuar kolegjiun për integrim evropian, ndërsa

në kuadër të Presidencës së Kosovës është themeluar Këshilli Nacional për integrim evropiane.

Komunat kanë nisur të punojnë në përmbushjen e obligimeve të dala nga MSA nga gjysma e dytë e vitit 2016. E arritur e veçantë është saktësimi i obligimeve që ka secila komunë veç e veç sa i përket përmbushjes së MSA. Ky ka qenë një proces i menaxhuar nga ana e MAPL-së.

E arritur tjetër në nivel lokal e këtij procesi është raportimi periodik që të gjitha komunat bëjnë të MAPL në lidhje me përmbushjen e obligimeve që dalin nga MSA. Gjatë vitit 2016 dhe 2017 ky raportim ka qenë katër herë brenda vitit, ndërsa në vitin 2018 ka pasur ndryshim dhe tani komunat raportojnë dy herë në vit.¹³ Pastaj MAPL e dërgon një përmbledhje të gjeturash të Ministria e Integritimit Evropian.

Hapja e zyrave të avokatit të popullit në objektet e komunave, krijimi i qasjes fizike në objektet publike për personat me aftësi të veçanta si dhe ofrimi i përkrahjes për OJQ dhe grupet tjera të interesit nga buxheti i subvencioneve konsiderohen të arritura tjera të komunave në përmbushjen e obligimeve që dalin nga MSA.¹⁴

Përveç kësaj, në shtatë komunat e mëdha janë shënuar të arritura në themelimin dhe inkuadrimin e minoriteteve në këshillat për siguri në bashkësi, zbatimin e obligimeve ligjore në përdorimin e gjuhëve zyrtare, ndërmarrja e masave në mbrojtjen e të dhënave personale, evidentimi i shkallës së braktisjes së shkollës nga nxënësit, largimi i deponive të egra nga zonat e banuara si dhe e arritur tjetër vlerësohet hartimi i planeve komunale në efikasitet të energjisë.¹⁵

Në bazë të raporteve zyrtare të MAPL-së, afro 70% e të gjitha kriterëve të parapara për komuna në fushën e MSA-së janë përmbushur. Ky është një vlerësim i cili del nga raportimet që bëjnë vetë komunat në MAPL dhe nuk bazohet në vlerësim dhe monitorim të gjendjes në terren nga ana e MAPL-së.¹⁶

Formimi dhe funksionimi i kolegjiut për integrim evropiane në kuadër të Asociacionit të Komunave të Kosovës mund të konsiderohet e arritur tjetër e këtij procesi. Ky kolegjiun mbledhet deri në gjashtë herë brenda vitit ku diskutohen dhe prezantohen shqetësimet dhe kërkesat e përbashkëta të gjithë zyrtarëve për integrim evropiane të komunave. Pastaj udhëheqësit e MAPL i adresojnë këto të vendimmarrësit institucional.¹⁷

9 Ministria e Integritimit Evropian. Marrëveshja për Stabilizim Asocim. Burimi: <https://bit.ly/2o3HqcY>

10 Ministria e Integritimit Evropian. Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA 2018-2022. Burim: <https://bit.ly/2Px0ufZ>

11 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Matrica e aktiviteteve për zbatimin e MSA. Shih Aneksin 1

12 Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Preambula. Burim: <https://bit.ly/2N8dGxe>

13 Intervistë me drejtorin e Drejtorisë për Integrim Evropiane në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal Shkelqim Jakupi.

14 Të dhëna të dala nga organizimi i shtatë fokus grupeve në shtatë komunat e mëdha të Kosovës.

15 Ibid

16 Ibid

17 Intervistë me Gani Berishen nga Asociacioni i Komunave të Kosovës.

Sfidat e komunave në përmbushjen e obligimeve që dalin nga MSA-ja

Komunat kanë një varg problemesh në rrugëtimin e tyre drejt përmbushjes së obligimeve që dalin nga agjenda evropiane e vendit.

Edhe përkundër ekzistencës së një rregulloreje nacionale e nxjerr nga Zyra e Kryeministrit në Qeverinë e Kosovës që mëton të rregullojë strukturën dhe kompetencat e komunave në fushën e integriteteve evropiane, gjendja në terren është e ndryshme. Në shumicën e komunave të Kosovës ka zyre për integritete evropiane, ndërsa në disa të tjera ka vetëm zyrtar për integritete evropiane (Prishtinë) dhe nuk është themeluar një zyre e veçantë. Në dy komuna (Peja dhe Mitrovica) është themeluar Drejtoria për Integritete Evropiane që e bën krejt të ndryshëm strukturën e komunave sa i përket procesit lokal të integriteteve evropiane.¹⁸

Problem tjetër në kuadër të strukturës komunale për integritete evropiane është çështja e koeficientit të pagës. Në disa raste, zyrtarët për integritete evropiane paguhet me koeficient 9.5, ndërsa ka raste tjera kur ky koeficient është 6.5.¹⁹

Në disa komuna, këto zyre kanë deri në katër persona të punësuar, ndërsa në shumicën e komunave, zyrtarët për integritete evropiane përbëhen nga vetëm një zyrtar i cili e mban pozitën e udhëheqës-it/es të zyrës. Në disa raste hasen emërtime si shef/e i/e zyrës për integritete evropiane.

Përgjegjësit për integritete evropiane nëpër komuna kryesisht ndihen të anashkaluar nga vendimmarrësit lokal. Këta përgjegjës në shumicën e rasteve nuk përfaqësohen në takimet e këshillit komunal të drejtorëve dhe rrjedhimisht as nuk janë të informuar në lidhje me planet e komunës dhe as nuk mund të ndikojnë në këto plane, ndonëse një gjë të tillë e kërkon rregullorja e zyrës së kryeministrit për zyrtarët për integritete evropiane nëpër komuna.²⁰

Zyrtarët për integritete evropiane në komunat e hulumtuara, nuk kanë qasje në databazën e trajnimeve që kryen stafi i komunës. Kjo u pamundëson atyre për të kuptuar resurset e brendshme të komunave në raste kur paraqitet nevoja në hartimin e projekteve të ndryshme.²¹

Ministria e Integritetit Evropian nuk ka asnjë komunikim

ose bashkëpunim me zyrtarët për integritete evropiane nëpër komuna. Kontributi i komunave në agjendën evropiane evidentohet dhe raportohet te Ministria e Integritetit Evropian nga ana e MAPL-së.²²

Një nga problemet e zyrave për integritete evropiane nëpër komuna është mungesa e burimeve njerëzore që do të mundësonte aplikimin dhe përfitimin e fondeve të BE-së dedikuar Kosovës. Përveç kësaj, një numër i udhëheqësve të zyrave për integritete evropiane në komuna nuk e njohin gjuhën angleze e rrjedhimisht e kanë të pamundur t'u qasen direkt këtyre fondeve ose të marrin pjesë në trajnime ose prezantime ku kërkohet njohja e gjuhës angleze.²³

Në përgjithësi, zyrtarët për integritete evropiane nëpër komuna kanë vështirësi për t'i marrë informatat nga drejtorët e drejtorive dhe qendrat tjera komunale në lidhje me aktivitetet e tyre që mund të bien në fushën e përmbushjes së MSA-së.

Një tjetër problem që i përcjell zyrtarët për integritete evropiane në komuna është shpërndarja e tyre në formë të ndryshme. Disa funksionojnë si zyra brenda Drejtorisë së Administratës, disa janë pjesë e kabinetit të kryetarit. Kjo pastaj paraqet problem në linjën e raportimit. Disave u duhet të raportojnë të drejtori i administratës dhe ai të dorëzojë raportin të MAPL për aktivitetet e ndërmarrë, ndërsa disa të tjerë raportojnë direkt të kryetarit nga i cili marrin nënshkrimin në raportin e aktiviteteve të kryera dhe të njëjtin e adresojnë në MAPL.²⁴

Mungon bashkëpunimi ndërmjet shoqërisë civile dhe zyrave për integritete evropiane në komuna. Në shumicën e rasteve këto zyra nuk kanë ndonjë shënim se cilat organizata jo qeveritare lokale do të mund të ofronin bashkëpunim në përmbushjen e disa nga aktivitetet e parapara nga MSA siç është promovimi i barazisë gjinore, luftës kundër narkotikeve në shkollë dhe fushatave të ndryshme që kanë të bëjnë kundër dhunës në familje, kundër braktisjes së shkollave ose imigrimit të paligjshëm.²⁵

Asnjë nga zyrtarët për integritete evropiane në komuna që kemi hulumtuar nuk ushtrojnë funksionin e vlerësimit të akteve juridike të komunave nëse ato janë në përputhje me direktivat e BE-së, ndonëse këtë e kërkon shprehimisht rregullorja e Zyrës së Kryeministrit e Qeverisë së Kosovës 08/2011.²⁶

Pjesa më e madhe e komunave nuk publikojnë në faqet zyrtare në internet asnjë njoftim, raport ose aktivitet që organizohet nga ana e zyrës për integritete evropiane. Po ashtu pjesa më e madhe e raporteve të punës gjashtë mujore dhe vjetore të zyrave të kryetarit nuk përfshijnë

18 Intervistë me udhëheqësit e zyrave për integritete evropiane në Prishtinë (AjsheBerveniku) në Pejë (SyzanaMuriqi) dhe në Mitrovicë (Sadije Jashari)

19 Intervistë me udhëheqësit e zyrave për integritete evropiane në shtatë komunat e mëdha të Kosovës.

20 Intervistë me udhëheqësit e zyrave për integritete evropiane në shtatë komunat e mëdha të Kosovës.

21 Ibid

22 Ibid

23 Ibid

24 Ibid

25 Të dhëna të dala nga organizimi i shtatë fokus grupeve në shtatë komunat e mëdha të Kosovës.

26 Intervistë me udhëheqësit e zyrave për integritete evropiane në shtatë komunat e mëdha të Kosovës.

ose nuk përmendin askund ndonjë nismë ose aktivitet të ndërmarrë nga ana e zyrave për integritime evropiane.²⁷

Sfida tjera të pushtetit lokal në përmbushjen e MSA janë edhe reforma e administratës publike. Ky është një proces ku zyrtarët për integritime evropiane duhet të koordinohen me drejtorin e administratës, zyrën e kryetarit dhe zyrën e personelit. Përgjithësisht komunat e kanë të paqartë këtë proces dhe nuk kanë arritur akoma të definojnë rolin e tyre në këtë drejtim.²⁸

Përveç kësaj në shumicën e komunave mungon rregullorja për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Ky është një obligim tjetër që e kërkon MSA dhe që bie në përgj të nivelit lokal. Mos hartimi i kësaj rregullore arsyetohet me mungesën e ligjit në nivel nacional për këtë fushë.

Komunat, po ashtu, kanë ngecur në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Përgjithësisht, komunat nuk kanë rregullore e cila e adreson këtë temë, nuk kanë të evidentuar masa që janë ndërmarrë në këtë drejtim, nuk janë të hartuara strategjitë lokale për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore si dhe mungojnë zyrtarët lokal të cilët do të ngarkoheshin me përgjegjësi përkatëse në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.²⁹

Po ashtu, haset shkallë e ulët e bashkëpunimit ose nismave ndër komunale në fushën e infrastrukturës, ambientit, turizmit, shërbimeve publike, por edhe në çështje të mbrojtjes së pyjeve, mbrojtjes së ujerave dhe mbrojtjes nga zhurma.

Pjesa më e madhe e komunave nuk e kanë emëruar ndonjë zyrtar/e kundër korrupsionit, ose siç quhet në MSA 'zyrtar-i/ja për integritet'. Po ashtu, pjesa më e madhe e komunave nuk kanë plan ose strategji lokale kundër korrupsionit, ndonëse në marrëveshjen e MSA kërkohet dhe obligohet niveli lokal për të hartuar plane dhe strategji të tilla.³⁰

Komunat nuk kanë kod të veçantë buxhetor për t'i mbështetur aktivitetet në fushën e integritimeve evropiane. Nga disa komuna, kjo është parë e nevojshme, ngase një numër i aktiviteteve që kanë të bëjnë me fushata informuese ose me mbështetje të projekteve të caktuara nuk mund të realizohen nga mungesa e buxhetit përkatës. Gjithashtu, komunat akoma nuk kanë nisur hartimin e planeve për menaxhimin e tokave rurale dhe atyre bujqësore. Përveç kësaj, ndonëse e kërkon MSA, komunat akoma nuk kanë një sistem të mirë rregulluar për inkasiminin e mjeteve financiare nga individë ose subjekte që shfrytëzojnë hapësirat publike për qëllime përfitimi. Raportet e Auditorit të Përgjithshëm në shumicën e komunave gjejnë dhjetëra lëshime të kësaj natyre.³¹

Po ashtu, pjesa më e madhe e komunave kanë akoma ngecje në bërjen transparent të tërë procesit të prokurimit dhe shpenzimit të buxhetit, mos ndaljen e ndërtimeve pa leje në zonat e mbrojtura dhe mungesën e planeve konkrete për integrimin e komunitetit RAE. MAPL nuk ka arritur të shtrijë detyrimin e saj që të gjitha komunat të raportojnë në këtë ministri në lidhje me aktivitetet e tyre në përmbushjen e MSA-së. Komuna e Zubin Potokut akoma nuk raporton në MAPL. Për më tepër nuk ka informata nëse kjo komunë ka të caktuar një zyrtar për integritime evropiane.

Ndërsa nga ana tjetër, raporti i fundit (2018) për vendin i Komisionit Evropian, kur përmend komunat, nxjerr vlerësimin se ky nivel i pushtetit duhet të punojë më shumë në përfshirjen e grave në vendimmarrje. Përveç kësaj, kërkohet rritje e transparencës buxhetore, trajtim i ndërtimeve pa leje, rritje e buxhetit bazuar në të hyra vetanake, modernizim i transportit publik. Gjithashtu, pushteti lokal duhet t'i ushtrojë kompetencat në mbrojtjen e personave të prekur nga dhuna në familje dhe personave me aftësi të veçanta. Raporti i vendit vë në pah se komunat nuk ushtrojnë kontroll të duhur në mbrojtjen e konsumatorëve si dhe, komunat në shumicën e rasteve shpërfillin rekomandimet e dala nga raportet vjetore të auditorit të përgjithshëm.³²

27 Të dhëna të dala nga organizimi i shtatë fokus grupeve në shtatë komunat e mëdha të Kosovës si dhe hulumtimi i web faqeve kryesore të komunave.

28 Intervistë me udhëheqësit e zyrave për integritime evropiane në shtatë komunat e mëdha të Kosovës.

29 Intervistë me udhëheqësit e zyrave për integritime evropiane në shtatë komunat e mëdha të Kosovës.

30 Ibid

31 Ibid

32 Ministria e Integritimit Evropian. Raporti për vendin. 2018. Burim: <https://bit.ly/2Mublt0>

Raste studimi: zbatimi i MSA-së në shtatë komunat të Kosovës

Vlerësimi i përmbushjes së kriterëve të MSA nga komuna është bërë duke u bazuar në intervistat e zhvilluara me udhëheqësit e zyrave për integrime evropiane, në bazë të dhënave të pranuara nga organizimi i fokus grupeve, në bazë të intervistave të zhvilluara në MAPL si dhe bazuar në raportet që komunat kanë dorëzuar në MAPL lidhur me aktivitetet e ndërmarra për përmbushjen e kushteve të dala nga MSA.

Komuna e Prishtinës

Komuna e Prishtinës nuk ka zyre për integritet evropiane, por një person është i ngarkuar me funksionin e zyrtares për integritet evropiane që bën pjesë në kabinetin e kryetarit. Komuna e Prishtinës është e vetmja në mesin e të gjitha komunave që raporti që drejtohet në MAPL nuk nënshkruhet nga ana e kryetarit të komunës, por vetëm nga zyrtari për integritet.³³

Të arriturat më të mëdha të kësaj komune në përmbushjen e obligimeve që dalin nga MSA, llogariten të jenë transparenca e punës së administratës, krijimi i qasjes fizike në objektet publike për personat me nevojë të veçanta, ofrimi i përkrahjes për OJQ-të dhe grupet tjera të interesit nga buxheti i subvencioneve, ndërmarrja e masave në mbrojtjen e të dhënave personale, evidentimi i shkallës së braktisjes së shkollës nga nxënësit si dhe largimi i deponive të egra nga zonat e banuara.

Përveç këtyre, të arriturat e kësaj komune në këtë fushë vlerësohen të jenë edhe modernizimi dhe lehtësimi i procedurave në pagesat e tatimit në pronë, zbatimimi i të drejtave pronësore, transparenca në procedurat e hartimit të buxhetit dhe me pjesëmarrje si dhe rritja e pjesëmarrjes së fëmijëve në institucionet e edukimit parashkollor.

Edhe përkundër kësaj, sfidat ose problemet në këtë komunë në përmbushjen e obligimeve që dalin nga MSA janë të konsiderueshme. Zyrtarja për integritet evropiane nuk ftohet në asnjë takim të këshillit të drejtorëve dhe nuk ka komunikim ose bashkëpunim me pjesën dërmuese të përfaqësuesve politik të komunës e për rrjedhojë nuk ka njohuri në lidhje me investimet dhe planifikimet në sektor të ndryshëm brenda komunës. Kjo zyrtare raporton drejtorit të administratës, praktikë kjo që nuk haset në komunat e tjera ku zyrtarët për integritet raportojnë direkt te kryetari i komunës. Kjo e fundit kërkohet edhe me rregulloren 08/2011 të Zyrës së Kryeministrit.³⁴

Zyrtarja për integritet evropiane nuk ka qasje në data bazën e komunës në lidhje me përgatitjet profesionale që kanë stafi i punësuar dhe as nuk është e informuar në lidhje me trajnimet që ndjek stafi. Kjo i pamundëson asaj që t'i shfrytëzojë resurset e brendshme për të aplikuar në fonde të ndryshme që ofron BE-ja. Komunës i mungon rregullorja për drejtat e njeriut dhe drejtat e fëmijëve. Po ashtu, komuna nuk ka një plan ose strategji përkatëse për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në kryeqytet, e cila është njëra prej obligimeve të para që dalin nga MSA.

Komuna e Prishtinës nuk ka të evidentuar numrin e bizneseve të regjistruara brenda vitit dhe atyre që shuhën, ndonëse në këtë drejtim ekzistojnë shifra që publikohen nga ana e Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës.

Komuna e Prishtinës po ashtu nuk ka arritur që të hartojë rregullore, plan ose strategji për luftë kundër korrupsionit, adresimin e rasteve të konfliktit të interesit si dhe nuk ka emëruar akoma një person në pozitën e zyrtar-it/es për integritet.

Përveç kësaj, komuna nuk ka një plan për menaxhimin e tokave bujqësore dhe atyre rurale. Ekziston akoma një shkallë e lartë e ekonomisë jo formale në sektorët që janë përgjegjësi të komunës si dhe akoma nuk ka ndonjë plan të shkruar për promovimin e barazisë gjinore. Përveç kësaj, konsiderohet sfiduese për Prishtinën mos plotësimi i standardeve në fushën e mbrojtjes nga zhurma.

Niveli i përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA të rasti i Komunës së Prishtinës bazuar në matricën e MAPL për vitin 2018



³³ Intervistë me zyrtaren për integritet evropiane në Komunën e Prishtinës AjsheBerveniku.

³⁴ Ibid

Tabela nr.1

Niveli i përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA të rasti i
Komunës së Prishtinës bazuar në matricën e MAPL për vitin 2018


Kriteret Politike

- Forcimi i kapaciteteve të administratës në nivel lokal
- Të zbatohet legjislacioni nacional për reformë në administratën publike
- Të ngritet transparenca e punës për gjitha organet e nivelit lokal
- Regrutimi i stafit të bëhet bazuar në kriteret ligjore dhe në merita profesionale
- Të krijohen kushtet që avokati i popullit të ketë hapësirë në ambientet e komunës
- Të zbatohen rekomandimet e avokatit të popullit
- Të sigurohet financim publik për shoqërinë civile
- Të rritet bashkëpunimi mes shoqërisë civile dhe komunave
- Të sigurohen masa në luftë kundër terrorizimit
- Ndërmarrja e fushatave për vetëdijesimin e qytetarëve kundër radikalizmit
- Të krijohen mekanizma për raportim obligativ lidhur me konfliktin e interesit
- Komuna duhet të ketë strategji kundër korrupsionit
- Zbatimi i pakove ligjore për drejtat e njeriut
- Ndërmarrja e veprimeve konkrete për barazi gjinore
- Miratimi i rregullores për drejtat e fëmijëve
- Zbatimi i drejtave pronësore veçmas për gratë
- Evidentimi i rasteve të trafikimit me qenie njerëzore
- Ndarja e buxhetit për mbrojtën e pakicave
- Të zbatohet në tërësi ligji për përdorimin e gjuhëve
- Hartimi i planeve konkrete për mbrojtën e trashëgimisë
- Sigurimi i masave për zonat e mbrojtura



Kriteret Ekonomike

- Krijimi i lehtësirave nga komuna për hapjen dhe zhvillimin e bizneseve
- A ekziston dhe a funksionon qendra "On Stop Shop"
- A janë procedurat e hartimit të buxhetit transparente dhe të qarta
- Zvogëlimi i ekonomisë jo formale në fushat e përgjegjësisë së komunave
- Planifikimi i pronës së komunal me qëllim të zhvillimit ekonomik
- Ndërtimi i një infrastrukture të kompletuar për biznese



Standardet Evropiane

- Komunat duhet të kenë plan për bujqësi dhe zhvillim rural
- A ka komuna master plan për tokat bujqësore
- A ka komuna të dhëna se sa tokë bujqësore është e përfshirë në ujitje
- A ka komuna qendër specifike për trajnimin e fermerëve
- A ka komuna të dhëna se si shfrytëzohet prona komunale
- A ka komuna plane se si të zbatohen rekomandimet e auditorit
- A ka plane se kur dhe ku duhet të ofrohet toka komunale në shfrytëzim
- A ka komuna plane për efikasitet të energjisë
- A ka zhvilluar komuna trajnime për zyrtaret në fushën e efikasitetit të energjisë
- A ka komuna statistika (trend) në fushën e efikasitetit të energjisë
- A ka komuna të caktuar zyrtar për mbrojtjen nga diskriminimi
- A ka komuna zyre për shërbime juridike falas
- A është caktuar zyrtari për mbrojtën e të dhënave personale
- A ekziston dhe a është funksionale zyra komunale për komunitete
- A ka formuar komuna komision për trajtimin e rasteve të riatdhesimit
- A ka komuna plan për mbrojtën dhe integrimin e minoriteteve
- A kanë mundësi shkollimi nëpër komuna për fëmijët me nevojë të veçanta
- A ka komuna të dhëna për numrin e braktisjes së shkollimit
- A ka zhvilluar ndonjë fushatë komunale për promovimin e shkollës profesionale
- A ka komuna plan për menaxhimin e mbeturinave
- A ka komuna plan të veprimit për cilësinë e ajrit
- A ka ndërmarr komuna masa për eliminimin e deponive ilegale
- A ka komuna inspektor të bujqësisë
- A ka komuna plan për menaxhimin e tokave rurale



Komuna e Prizrenit

Komuna e Prizrenit ka zyre të veçantë për integritet evropian dhe cila bën pjesë në kabinetin e kryetarit. Në kuadër të kësaj zyre është e punësuar një zyrtarë dhe cila mban pozitën e udhëheqëses së zyrës. Ajo, për punën e saj, raporton te kryetari i komunës dhe raportet që dërgohen të MAPL nënshkruhen nga ana e kryetarit.³⁵

Të arriturat më të mëdha të kësaj komune në përmbushjen e obligimeve që dalin nga MSA llogariten të jenë nismat në reformën e administratës publike, transparenca e punës, hartimi i buxhetit me pjesëmarrje të qytetarëve, ngritja e kapaciteteve në zyrën “One Stop Shop”, hapja e zyrës së avokatit të popullit në objektet e komunës, buxhetimi gjinor, zbatimi i të drejtave pronësore, implementimi i ligjit për përdorimin e gjuhëve zyrtare, ngritja e kapaciteteve profesionale në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, evidentimi i braktisjes së shkollës nga ana e nxënësve si dhe ndërmarrja e masave në riatdhesimin dhe riintegrimin e personave që ju është refuzuar azili në shtetet e BE-së. Përveç këtyre, Prizreni ka funksional Zyrën Komunale për Komunitete dhe po ashtu ekziston personi ose zyrtari i posaçëm për mbrojtjen e të dhënave personale.³⁶

Ngjashëm si të rasti i Komunës së Prishtinës, edhe në Prizren udhëheqësja e zyrës për integritet evropian nuk ftohet për t’u përfaqësuar në takimet e rregullta të këshillit të drejtorëve. Për më tepër, kjo zyre nuk merr pjesë as në diskutimet që bëhen për buxhetin si dhe për planin e punës.


Problematikë tjetër të rasti i Prizrenit është mungesa e buxhetit për zyrën për integritet, mungesë kjo që ndikon negativisht në përmbushjen e disa kriterëve të MSA-së.

Zyra për integritet evropian në këtë komunë konsideron që inkuadrimi në zyre i disa profileve të caktuara do t’i mundësonte komunës të aplikonte dhe përfitonte nga fondet e BE-së që i dedikohen Kosovës.

Kjo zyre nuk ka një data bazë se cilat janë organizatat e shoqërisë civile në komunë që do të mund të mbështesnin disa nga aktivitetet e saj dhe po ashtu kjo zyre nuk ka qasje në dhënat e komunës se cila është përgatitja profesionale e punonjëseve dhe se në ku po kryhen trajnimet

Ndërkaq, sfidat më të mëdha dalin të jenë mungesa e zbatimit të legjislacionit në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, ndërmarrja e veprimeve në adresimin e problemeve që dalin nga ndërtimet ilegale në zonat e mbrojtura dhe zvogëlimi i nivelit të ekonomisë jo formale në fushat që janë kompetencë e komunës. Po ashtu, sfida konsiderohen mungesa e një plani të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit, ndërtimi i një infrastrukture fizike të kompletuar dhe të gatshme për ushtrimin e veprimtarisë së biznesit, mungesa e strategjisë ose planit komunal për mbrojtjen e tokës bujqësore. Prizreni ka akoma punë për t’i përmbushur obligimet që dalin nga MSA si në trajnimin e stafit përkatës në zbatimin e planit komunal për efikasitet të energjisë. Mungesa e komitetit konsultativ për persona me nevojë të veçanta, mungesa e një zyre në komunë për ndihmë juridike falas, mungesa e projekteve në fushën e bashkëpunimit ndër komunal si dhe ngecje në mbrojtjen e shëndetit publik veçmas në respektimin e ligjit për mos lejinin e pirjes së duhanit në hapësirat e mbyllura janë disa nga sfidat tjera.

Niveli i përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA të rasti i Komunës së Prizrenit bazuar në matricën e MAPL për vitin 2018



³⁵ Intervistë me udhëheqësen e Zyrës për Integritet Evropian në Prizren Eleonora Fetollari.

³⁶ Ibid

Tabela nr.2

Niveli i përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA të rasti i
Komunës së Prizrenit bazuar në matricën e MAPL për vitin 2018

Kriteret Politike

- Forcimi i kapaciteteve të administratës në nivel lokal
- Të zbatohet legjislacioni nacional për reformë në administratën publike
- Të ngritët transparenca e punës për gjitha organet e nivelit lokal
- Regrutimi i stafit të bëhet bazuar në kriteret ligjore dhe në merita profesionale
- Të krijohen kushtet që avokati i popullit të ketë hapësirë në ambientet e komunës
- Të zbatohen rekomandimet e avokatit të popullit
- Të sigurohet financim publik për shoqërinë civile
- Të rritet bashkëpunimi mes shoqërisë civile dhe komunave
- Të sigurohen masa në luftë kundër terrorizmit
- Ndërmarrja e fushatave për vetëdijesimin e qytetarëve kundër radikalizmit
- Të krijohen mekanizma për raportim obligativ lidhur me konfliktin e interesit
- Komuna duhet të ketë strategji kundër korrupsionit
- Zbatimi i pakove ligjore për drejtat e njeriut
- Ndërmarrja e veprimeve konkrete për barazi gjinore
- Miratimi i rregullores për drejtat e fëmijëve
- Zbatimi i drejtave pronësore veçmas për gratë
- Evidentimi i rasteve të trafikimit me qenie njerëzore
- Ndarja e buxhetit për mbrojtën e pakicave
- Të zbatohet në tërësi ligji për përdorimin e gjuhëve
- Hartimi i planeve konkrete për mbrojtën e trashëgimisë
- Sigurimi i masave për zonat e mbrojtura



Kriteret Ekonomike

- Krijimi i lehtësirave nga komuna për hapjen dhe zhvillimin e bizneseve
- A ekziston dhe a funksionon qendra "On Stop Shop"
- A janë procedurat e hartimit të buxhetit transparente dhe të qarta
- Zvogëlimi i ekonomisë jo formale në fushat e përgjegjësisë së komunave
- Planifikimi i pronës së komunal me qëllim të zhvillimit ekonomik
- Komunat duhet të kenë plan për bujqësi dhe zhvillim rural
- Ndërtimi i një infrastrukture të kompletuar për biznese



Standardet Evropiane

- A ka komuna master plan për tokat bujqësore
- A ka komuna të dhëna se sa tokë bujqësore është e përfshirë në ujitje
- A ka komuna qendër specifike për trajnimin e fermerëve
- A ka komuna të dhëna se si shfrytëzohet prona komunale
- A ka komuna plane se si të zbatohen rekomandimet e auditorit
- A ka plane se kur dhe ku duhet të ofrohet toka komunale në shfrytëzim
- A ka komuna plane për efikasitet të energjisë
- A ka zhvilluar komuna trajnime për zyrtarët në fushën e efikasitetit të energjisë
- A ka komuna statistika (trend) në fushën e efikasitetit të energjisë
- A ka komuna të caktuar zyrtar për mbrojtjen nga diskriminimi
- A ka komuna zyre për shërbime juridike falas
- A është caktuar zyrtari për mbrojtën e të dhënave personale
- A ekziston dhe a është funksionale zyra komunale për komunitete
- A ka formuar komuna komision për trajtimin e rasteve të riatdhesimit
- A ka komuna plan për mbrojtën dhe integrimin e minoriteteve
- A kanë mundësi shkollimi nëpër komuna për fëmijët me nevojë të veçanta
- A ka komuna të dhëna për numrin e braktisjes së shkollimit
- A ka zhvilluar ndonjë fushatë komunale për promovimin e shkollës profesionale
- A ka komuna plan për menaxhimin e mbeturinave
- A ka komuna plan të veprimit për cilësinë e ajrit
- A ka ndërmarr komuna masa për eliminimin e deponive ilegale
- A ka komuna inspektor të bujqësisë
- A ka komuna plan për menaxhimin e tokave rurale



Komuna e Pejës

Komuna e Pejës, strukturën e integritimeve evropiane e ka rregulluar duke themeluar drejtori të posaçme të cilën e ka emërtuar 'Drejtorja për Integritime Evropiane dhe Diasporë'. Ngritja e kësaj çështje në nivel të drejtorisë është në kundërshtim me rregulloren e Zyrës së Kryeministrit, ngase aty precizohet se çështjet e integritimeve evropiane nëpër komuna duhet trajtuar në nivel të zyrave. Kjo drejtori nuk është krijuar në mënyrë specifike për integritime evropiane, por në përshkrimin e funksioneve merret edhe me çështjet e diasporës.³⁷

